

VENDIM
Nr. 203, datë 27.9.2024

**MBI FILLIMIN E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS SË SHOQËRISË “DRIBEN”
SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.9.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1857/4 prot., datë 25.9.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Driben’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Driben” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1857 prot., datë 3.9.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 187, datë 12.9.2024, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Driben” sh.p.k., për arsye se nga ana e saj nuk ishte kryer pagesa e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 1857/2 prot., datë 16.9.2024, duke i dhënë dhe udhëzimet përkatëse.

- Në vijim, shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për llogari të ERE-s, në datën 18.9.2024, pra brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës 19.7.2024, ndaj, në mbështetje të parashikimeve të nenit 10, pikës 7, të rregullores së sipërcituar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për fillimin e procedurës.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gerrat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gerrat “a” dhe “c” dhe për pikën 2.1 gerrat “a”, “b”, “d” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “Driben” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën me nr. 10518 rep., nr. 4880 kol., datë 28.12.2023;

- Ka depozituar në ERE shkresën nga “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a. nr. 6617/3 prot., datë 13.10.2022, për miratimin e lidhjes së centralit fotovoltai me rrjetin e shpërndarjes. Në përputhje me përcaktimet e “Rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarje”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 166, datë 10.10.2016, të ndryshuar, por duke qenë se kanë kaluar rreth 2 dy vjet nga marrja e këtij miratimi, duhet të depozitohet në ERE marrëveshja e nënshkruar me “OSSH” sh.a., si dhe të depozitohet informacion apo dokumentacion në lidhje me statusin e këtij miratimi.

- Është pajisur me vendim për VNM paraprake, lëshuar më 31.8.2022, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të ndërtuar impiantin fotovoltaik me fuqi 2 mw. Rezulton se kjo VNM e ka humbur vlefshmërinë e saj (ka qenë e vlefshme deri më 31.8.2024) dhe nuk është depozituar informacion/dokumentacion në lidhje me fillimin e punimeve, ndaj shoqëria duhet të dokumentojë fillimin e punimeve dhe nëse punimet e ndërtimit kanë filluar brenda këtij afati, në të kundërt duhet të depozitojë në ERE një VNM të re.

- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet dhe informacioni/dokumentacioni në vijim:

Neni 9

Pika 1, "Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë";

Pika 1.3, "Aplikuesi duhet të depozitojë dokumentacionin financiar dhe fiskal si vijon:".

- Germa "b": Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE njoftimin përkatës drejtuar MIE-s, në lidhje ndryshimin e vlerës së investimit dhe qëndrimin e kësaj të fundit, ose amendimin e kontratës, në rast se ka pasur një të tillë. Po ashtu, duhet të depozitojë saktësimet/sqarimet përkatëse në lidhje me shkresën dhe financimin përkatës të bankës, si dhe të dokumentojë mbulimin e 20% të vlerës së investimit, të cilin sipas planit të biznesit, ka parashikuar ta kryejë me fondet e veta.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Driben" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Driben" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti